



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 131 Prot

Tiranë, më 07.09, 2012

VENDIM QARKULLUES Nr. 232, datë 07.09, 2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Impianti i depolimerizimit (shpërbërje) të gomave të përdorura për prodhim energjie (Komuna Katund i Ri, Durrës)", mbi bazën e kërkesës së Subjektit "La Vitoria" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës për Projektin: "Impianti i depolimerizimit (shpërbërje) të gomave të përdorura për prodhim energjie (Komuna Katund i Ri, Durrës)" - Subjekti "La Vitoria" sh.p.k.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër bazuar në kontratën dypalëshe midis "La Vitoria" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("La Vitoria" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al